ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **Kompania Rajonale e Ujësjellësit GJAKOVA SH.A.**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i prokurimit	**KRURGJA-24-11650-1-2-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizimi me rërë**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

NSHT Viktory com Pjeter qerimi B.I

Rr.Tirana

Gjakove *50,000*

045 810 461

Pjeter Qerimi

Info@viktory-ks.com

23.12.2024

PJETER QERIMI B.I. N.SH.T. "VIKTORY COM" GJAKOVE NUI 810244541

(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" apo "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Njoftimi per kontrate 11.11.2024
Hapja e ofertave 02.12.2024
Njoftimi mbi vendimine 09.12.2024
Kerkesa per rishqyrtim me date 11/12/2024
Refuzimi I kerkese per rishqyrtim me date 12/12/2024
Ankesa ne Oshp me date 23/12/2024

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [x] **Jo** [ ]

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur

me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po [x] **Jo** [ ]

Ne jemi njoftuar me shkrim ne lidhje me eliminimin tone ku kemi marr vendimin: Njoftim mbi vendim eshte me date 10-12-2024 *Me pas kemi bere kerkes per rishqyrtim ku nuk jemi pajtuar me mendimin e AK pasi ka qene I pa drejt dhe ne kundershtim me Ligjin e Prokurimit Publik dhe ne kundershtim me* UDHËZUES Nr.001/2023 dhe me RROUPP-ne dhe me pas kemi bere : *Kerkesen per rishqyrtim me date 11-12-2024* *Kurse Refuzimi I kerkeses per rishqyrtim eshte me date 12-12-2024*

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK ka shkelur nenin 1 Qellimi të LPP-së Nr. 04/L-042
AK ka shkelur nenin 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti të LPP-së Nr. 04/L-042
AK ka shkelur nenin 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi të LPP-së Nr. 04/L-042
AK ka shkelur nenin Neni 28 Specifikimet teknike
AK ka shkelur nenin Neni 37 Mostrat e Tenderit Rregullorja Nr.001/2022 Per Prokurim Publik
AK ka shkelur nenin 56 të LPP-së Nr. 04/L-042
AK ka shkelur nenin 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës të LPP-së Nr. 04/L-042
AK ka shkelur nenin 68 Gjendja Ekonomike dhe Financiare AK ka shkelur nenin 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale të LPP-së Nr. 04/L-042

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Objekti i Ankesës

Përmes kësaj ankese, paraqesim shqetësimin tonë lidhur me procesin e tenderimit të zhvilluar nga **Kompania Rajonale e Ujësjellësit GJAKOVA SH.A.** për tenderin **"Furnizim me Rerë".** Ne besojmë se AK ka shkelur dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) dhe ka vepruar në kundërshtim me parimet e transparencës, trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë dhe drejtësisë.

Pretendimi 1: Mungesa e dokumenteve të detyrueshme nga OE fitues

Sipas dosjes së tenderit, operatorët ekonomikë ishin të detyruar të dorëzonin:

- Listë të furnizimeve të kryera, duke përshkruar furnizimet e ngjashme, shumën e kontratave dhe kohën e realizimit;
- Certifikata ose raporte pranimi të lëshuara nga blerësit, ose dëshmi të pagesave.

Përkundër kësaj, kompania e shpallur fituese "Valdrini-A" SH.P.K. nuk ka dorëzuar dokumentet e mësipërme:

- Mungesa e listës së furnizimeve të kryera dhe referencave specifike;
- Mungesa e dokumentacionit të nevojshëm që vërteton përvojën e saj në furnizime të ngjashme.

AK ka refuzuar të na ofrojë qasje të plotë në dokumentet e OE fitues, duke u mbështetur në pretendimin për "konfidencialitet afarist" sipas nenit 69 të LPP-së. Ne argumentojmë se referencat dhe dokumentacioni për furnizimet e ngjashme nuk përmbajnë informacione konfidenciale dhe janë të domosdoshme për të vërtetuar përputhshmërën e OE fitues me kriteret e tenderit.

Nenet 68 dhe 69 të LPP-së përjashtojnë nga konfidencialiteti dokumentet që janë thelbësore për vlerësimin e ofertave.

Pretendimi 2: Referencat e OE-ve pjesëmarrëse nuk përputhen me kriteret e tenderit

Dosja e tenderit kërkon qartë që operatorët ekonomikë të dorëzojnë referenca specifike për furnizime të natyrës së ngjashme me zhavorr. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar:

- OE "Valdrini-A" dhe operatorë të tjerë nuk kanë dorëzuar referenca që përputhen me furnizimin me zhavorr, por referenca për punime të përgjithshme.

Ky fakt bie në kundërshtim me specifikimet teknike të vendosura nga AK, duke shkelur parimin e transparencës dhe trajtimit të barabartë.

Pretendimi 3: Kriteri i posedimit të licencës dhe Ligji për Miniera dhe Minerale

Në bazë të dosjes së tenderit të shpallur nga AK, një nga kriteret kryesore për pjesëmarrje ishte:

"Operatori Ekonomik duhet të posedojë një licencë valide për shfrytëzimin e shkëmbit të fortë nga KPMM."

Kompania jonë "Viktory Com" ka dorëzuar dokumentacionin e mëposhtëm për të përmbushur këtë kriter:

1. Një marrëveshje të vlefshme me një kompani tjetër (e cila është e pajisur me licencë valide nga KPMM për shfrytëzimin e shkëmbit të fortë).
2. Licencën valide të kompanisë partnere si dëshmi e kapacitetit për të përmbushur kriteret e tenderit.

Argumentet tona:

- Marrëveshja jonë është plotësisht në përputhje me dosjen e tenderit dhe praktikën e prokurimit. Ligji për Prokurimin Publik dhe praktika në prokurim publik lejojnë që operatorët ekonomikë të demonstrojnë kapacitetin teknik dhe profesional përmes kontratave ose marrëveshjeve me kompani të treta që posedojnë resurset e nevojshme. Marrëveshja jonë mbulon plotësisht kapacitetin tonë për të përmbushur kriteret e tenderit.
- Mospranimi i dokumentacionit tonë dhe favorizimi i OE-së fitues bie në kundërshtim me parimin e trajtim të barabartë, i cili është i përcaktuar në nenin 7 të Ligjit për Prokurimin Publik. Ky parim nënkupton që çdo operator ekonomik duhet të vlerësohet në bazë të dokumenteve të dorëzuara dhe përputhshmërës së tyre me kriteret e përcaktuara, pa diskriminim apo favorizim.
- Neni 10 i Ligjit për Miniera dhe Minerale nuk ndalon që një kompani të përdorë licencën e një pale të tretë për aq kohë sa ekziston një marrëveshje ligjërisht e vlefshme, dhe kjo licencë mbetet e paprekur nga ndonjë transferim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë.

AK ka interpretuar gabimisht këtë dispozitë duke e trajtuar dokumentacionin tonë si të pavlefshëm dhe duke shpallur OE fitues vetëm sepse posedon një licencë direkte, ndërkohë që Ligji dhe dosja e tenderit nuk e përjashtojnë shfrytëzimin e kapaciteteve të një pale të tretë.

Kërkesat tona

Duke u mbështetur në faktet e sipërpërmendura, kërkojmë që OSHP të:

1. Urdhërojë AK-në të sigurojë qasje të plotë në dokumentacionin e OE fitues, për të verifikuar përputhshmërën e tij me kriteret e tenderit.
2. Anulojë vendimin për shpalljen e OE "Valdrini-A" si fitues, për shkak të mosplotësimit të kritereve thelbësore.
3. Rishqyrtojë vlerësimin e ofertave, duke siguruar që të gjitha ofertat të vlerësohen në përputhje të plotë me dosjen e tenderit dhe Ligjin për Prokurimin Publik dhe ne baze te nenit 1 Qellimi, ku thelbsore e ketij neni eshte rujta dhe menaxhimi I paras publike

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Dëmet materiale që shkaktohen nëse nuk e marrin këtë kontratë jane te konsiderushme si ne fushen financiare.

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, dhe*
- *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*